

Marketingu përmes rrjeteve sociale

Në vitet e fundit teknologjia ka pasur një hov të madh në zhvillimin e saj. Është parashikuar që para shumë kohësh zhvillimi në këtë fushë dhe ndikimi i saj masiv tek njerëzit. Vetëm kushtoni vëmendje gjatë një dite të jetës suaj se sa shumë njerëz përdorin rrjetet sociale tani të mundshme edhe në telefonat e tyre të menqur. Ne jemi të kyqur në rrjete sociale qoftë në një kafiteri, në një darkë, në një ditë të bukur në park apo edhe në shtëpinë e dikujt ku jemi të ftuar. Teknologjia është kudo dhe bashkë me të edhe rrjetet sociale. Nga një kërkim të bërë nga “ Pew Internet “, në gusht të vitit 2012, është gjetur se 69% të rritur nga e gjithë bota, janë të kyqur në rrjetet sociale. Disa nga rrjetet sociale më të përdorura nga njerëzit janë Facebook-u, duke vazhduar me LinkedIn, Twitter, YouTube, Pinterest, Instagram, Tumblr dhe shume blogje të tjera. Vetëm në rrethin ku ne jetojmë kemi një shoqëri të gjerë e cila përdorë rrjetet sociale. Imagjinoni sikur ju të kishit një biznes në kuadër të të cilit do të donit të reklamoni oferta të ndryshme, një nga mënyrat më të mira, më efektive dhe më të përodura në kohët e fundit, është marketingu përmes rrjeteve sociale.

Do ta marr si shembull reklamimin apo informimin e një oferte nga një biznes i caktuar, në rrjetin social Facebook. Hapi i parë që do të bënit është të hapnit një faqe në Facebook me emrin e biznesit tuaj. Duhet që faqja të ketë të gjitha informatat e duhura në lidhje me të, duhet të ketë ca foto të lokacionit dhe pamjes se brendshme të ndertesës ku gjinden artikujt, kjo do tu jepte të gjithë njerëzve që do ta shihnin faqen, një pamje paksa më të qartë në lidhje me biznesin tuaj. Duhet që të kemi parasysh që faqja duhet të jetë sa më atraktive në mënyrë që njerëzit të tërhiqen nga ajo. Hapi i dytë do të ishte shpërndarja e faqës suaj. Së pari do t'i ftonit miqtë tuaj që ta pëlqenin faqen e krijuar nga ju, e pastaj miqtë tuaj ta shpërndajnë atë teq miqtë e tjerë të tyre, me të cilët ju nuk keni kontakt. Pastaj e gjitha shkon zingjirë edhe miqtë e miqëve tuaj do ta shpërndanin tek njerëzit e tjerë dhe kështu faqja juaj do të bëhej shumë më e popullarizuar. Të gjitha të rejat në lidhje me biznesin tuaj, do t'i paraqitnit aty, dhe ne këtë mënyrë do të informonit njerëzit të cilët kanë pëlqyer faqen tuaj. Një mënyrë tjetër e shpërndarjes është një mënyrë paksa më indirekte, ku nëse miku juaj do ta pëlqente një postim nga faqja juaj, ajo direkt to të dilte në home, dhe miqtë e atij personi do ta shihnin atë postim, dhe në qoftë se do të ishte një postim atraktiv me siguri që edhe personi në fjalë do ta pëlqente. Facebook-u si i klasifikuar si rrjeti social më i përhapur besoj së është një mënyrë shume efikase dhe ideale për marketingun e biznesit tuaj.

Një shembull tjetër për reklamim apo marketing te biznesit tuaj, padyshim se është edhe Tëitter. Tëitter është shumë i përdorur nga njerëzit nga e gjithë bota. Ndonëse jo shumë i përodur sa Facebook-u, ai prap ka efektin e vet. Shumë njerëz vendosin të mos hapin Facebook, por në vend të tij të përdorin Tëitter. Pra për të informuar edhe me mirë njerëzit krahas faqes në Facebook, do të ishte mirë të qelnit edhe një Tëitter Account, gjithashtu me emrin e biznesit tuaj, me informatat e tij dhe me fotot. Përmes Tëitter-it do të ishte një mundësi shume e mirë që bizensin tuaj ta zgjeronit edhe jasht vendit, ku nëse do të arrinit shumë famë dhe emri i tij të dilte tek Trends, shume njerëz nga vende të ndryshme të botës do të kishin mundësinë të klikonin aty dhe të informoheshin për atë biznes. Kush nuk do ta dëshironte një gjë të tillë? Për të arritur diçka si kjo do të duhej që faqja juaj të kishte një numër të madh të përcjellësve në Tëitter, të cilët do ta përkrainin biznesin tuaj dhe do të ishin dakord me idetë e tij, në mënyrë që ai të përhapej sa më shumë

Të gjithë ne, përdorim YouTube pothuajse çdo ditë të jetës sonë. Edhe metoda e marketingut përmes YouTube është një metodë shumë e mirë pasi që është një Eëbsite i klikuar nga shumë njerëz dhe mundësinë e shpërndarjes e ka shume efikase. Në një anë, marketingu përmes videos ka shumë përparësi pasi që është shumë mirë kur njerëzit e shohin një reklamë me anë të një video-je. Në vitin e fundit e kemi vërejtur edhe

një të re në YouTube, ku kur ne klikojmë video, para se të fillojë videoja që e kemi klikuar, fillimisht na paraqitet një reklamë e cila na informon për një firmë të caktuar. Pra kjo metodë do të ishte shumë e mirë sepse njerëz nga vende të ndryshme do të ishin në gjendje ta shihnin atë reklamë.

Një mënyrë shumë e mirë për përdorimin e rrjeteve sociale, përveq informimeve për biznese të ndryshme, është edhe humaniteti. Ka faqe të shumta të cilat japin informacione, mbi njerëz të sëmurë që kanë nevojë për gjak dhe për gjëra tjera të nevojshme për mbijetesë, apo për njerëz që kanë nevojë për ndihmë sociale. Edhe nëse nuk ka faqe të veçanta që mirren posaqërisht për këto probleme, ka shume njerëz që në faqen e tyre të biznesit ku kanë shumë pelqime, informojnë njerëzit për gjëra të tilla urgjente, në mënyrë që ta shpërndajnë sa më shumë informacionin.

Nga krejt kjo mund të nxjerrim se rëndësia e rrjeteve sociale për marketing ka një peshë shumë të madhe. Është shumë thjeshtë të përdoret nga persona të zakonshëm dhe është një mënyrë tejet efikase dhe e shpejtë për shpërndarjen e informacioneve, e cila mund të themi se po përdoret më shumë ditët e sotme.

Patrisa Pruthi
KI XI/1